VENDIM
Nr.153, datë 7.12.2011

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA "HEC LANABREGAS" SHA PËR PERIUDHËN E TRETË RREGULLATORE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 pika 1, 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008 "Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike", pikat 4.13, neneve 15, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, vendimit nr.77, datë 26.6.2008 "Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2011, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike nga Hec Lanbregas, për periudhën e tretë rregullatore,

VENDOSI:

1. Tarifa e prodhimit të energjisë elektrike nga "Hec Lanabregas" sh.a., për periudhën e tretë rregullatore (vitet 2012-2014), do të jetë 6.25 lekë/kWh.

2. Ngarkohen Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e "Hec Lanbregas" sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 1.1.2012.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani